



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-126

PËR TE HUAJT

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Më qëllim te vendosjes së rregullave ligjore për të huajt,

Miraton

LIGJ PËR TE HUAJT

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi i Ligjit

1. Me këtë ligj rregullohet hyrja, lëvizja dhe qëndrimi i të huajve në Republikën e Kosovës.
2. Dispozitat e këtij ligji lidhur me qëndrimin e të huajve nuk vlejnë për pjesëtarët e posteve diplomatike dhe konsulare, për pjesëtarë të organizatave të Kombeve të Bashkuara dhe institucionet tjera të specializuara të Kombeve të Bashkuara, pjesëtarë të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Kosovës dhe pjesëtarët e familjes së tyre.

Neni 2

Përkufizimet

Nocionet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

“**I huaj**” është personi i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës,

“**Qytetari**” është shtetasi i Republikës së Kosovës.

“**Organ kompetent**” është Ministria e Punëve të Brendshme.

Neni 3

Përparësia e shtetësisë

I huaji i cili posedon me shumë se një shtetësi konsiderohet shtetas i atij shteti që i ka lëshuar atij/asaj dokumentin e udhëtimit dhe më të cilin ai/ajo ka hyrë në Republikën e Kosovës.

Neni 4

E drejta e hyrjes

1. I huaji mund të hyjë dhe të qëndrojë në territorin e Republikës së Kosovës vetëm me dokument të vlefshëm udhëtimit në të cilin është shënuar viza apo leje qëndrimi, përveç nëse me dispozitat e këtij ligji apo me marrëveshje ndërkombëtare nuk parashihet ndryshe.

2. Të huajit pa dokument udhëtimit të vlefshëm i lejohet hyrja në Republikën e Kosovës, nëse Republika e Kosovës është e obliguar ta pranojë atë sipas marrëveshjes ndërkombëtare.

Neni 5

Pasaportat e përbashkëta

1. I huaji i cili është shënuar në dokumentin e udhëtimit të personit tjetër mund të hyjë dhe të dalë nga Republika e Kosovës vetëm me personin në dokumentin e të cilit ai/ajo është shënuar.

2. Përjashtimisht nga neni 5. 1, i mitur i huaj, mund të hyjë dhe të dalë nga territori i Republikës së Kosovës në mungesë të prindit apo kujdestarit ligjor në pasaportën e të cilit ai/ajo është e përfshirë vetëm me autorizim të veçantë të organit kompetent.

3. Të huajt të cilët kanë pasaportë të përbashkët mund të hyjnë dhe të dalin nga Republika e Kosovës vetëm së bashku dhe duhet të kenë një dokument i cili përmban fotografinë e tyre i cili mund të përdoret për të konfirmuar identitetin e tyre. Udhëheqësi i grupit duhet patjetër të posedojë dokumentin personal të udhëtimit.

Neni 6

Liria e lëvizjes

1. Çdo person me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Kosovës, gëzon të drejtën e lëvizjes së lirë dhe zgjedhjes së lirë të vendbanimit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

2. Lëvizja e të huajve brenda territorit të Kosovës mund të kufizohet vetëm në përputhje me ligjin dhe vetëm në atë shkallë që është e domosdoshme në një shoqëri demokratike, me qëllim të:

2.1. Mbrojtjes së interesave vitale të sigurisë kombëtare;

2.2. Parandalimit të kërcënimeve serioze dhe urgjente lidhur me sigurinë dhe rendin publik;

2.3. Parandalimit të kërcënimeve serioze dhe urgjente kriminale;

2.4. Parandalimit të kërcënimeve serioze dhe urgjente lidhur me shëndetin dhe/ose moralin publik;

2.5. Parandalimit të kërcënimeve serioze dhe urgjente lidhur me të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Neni 7

Respektimi i Ligjit

I huaji duhet të respekton ligjet dhe rregulloret, përfshirë aktet nënligjore dhe vendimet e organeve shtetërore gjatë qëndrimit dhe lëvizjes së tij/saj në Republikën e Kosovës.

Neni 8

E drejta për asocim

1. I huaji mund të formojë asociacione në pajtim me ligjin.
2. Të huajit nuk i lejohet formimi i partive politike.

Neni 9

Procedurat Administrative

Procedura administrative lidhur me të huajt i nënshtrohet ligjit mbi procedurën administrative përveç nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

KREU II

DOKUMENTET E UDHËTIMIT

Neni 10

Dokumenti i huaj i udhëtimit

1. Dokument i huaj udhëtimi nënkupton vetëm ato dokumente udhëtimi të lëshuara nga shtetet e huaja si: Pasaporta personale apo familjare, pasaporta e përbashkët, pasaporta diplomatike, pasaporta zyrtare, librezë detare, librezë e tragetit apo dokumente të tjera udhëtimi të lëshuara sipas marrëveshjeve ndërkombëtare.
2. Dokumente Udhëtimi për të huaj, të lëshuara nga Republika e Kosovës janë:
 - 2.1. dokumenti i udhëtimit për të huajin;
 - 2.2. fletudhëtimi për të huajin;
 - 2.3. dokumenti i udhëtimit për refugjat;
 - 2.4. dokumenti i udhëtimit për persona pa shtetësi.

Neni 11

Lëshimi i Dokumenteve të Udhëtimit për të Huajt

1. Dokumenti i udhëtimit për të huajin mund t'i lëshohet personit i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës, sipas kushteve të parapara me këtë ligj dhe me ligjin për azilin.
2. Dokumentin e udhëtimit për të huaj e lëshon organi kompetent sipas vendbanimit të të huajit.
3. Fletudhëtimi për të huaj mund të lëshohet nga misioni diplomatik, përkatësisht zyrat konzullare të Republikës së Kosovës apo organi kompetent në Republikën e Kosovës.
4. Dokumentet e udhëtimit për të huaj lëshohet me afat vlefshmërie deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 12

Lëshimi i Fletudhëtimit për të huajt

1. Fletudhëtimi për të huaj lëshohet të huajit i cili nuk posedon dokument të vlefshëm udhëtimi nëse:
 - 1.1. Atij/Asaj i është marrë shtetësia e Republikës së Kosovës në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shtetësinë.

1.2. Ai/ajo ka humbur dokumentin e udhëtimit apo në ndonjë mënyrë tjetër ka mbetur pa të, ndërsa shteti shtetas i të cilit është nuk ka mision diplomatik gjegjësisht zyrë konzullare në Republikën e Kosovës e as interesat e tij nuk ka kush t'i përfaqësoj nga një shtet tjetër për dalje jashtë vendit.

2. Fletudhëtimi mund t'i lëshohet të huajit nëse për këtë ekzistojnë shkaqet e arsyeshme me pëlqimin e organit kompetent.

Neni 13

Moslëshimi dhe Konfiskimi i Dokumentit të Udhëtimit për të Huaj

1. Dokumenti i udhëtimit për të huaj nuk i lëshohet të huajit:

1.1 kundër të cilit zhvillohet procedura penale, përveç nëse ekziston pëlqimi i organit shtetëror i cili udhëheq procedurën;

1.2 cili është i dënuar me burg ose dënim me te holla, për derisa nuk e vuan dënimin ose paguan dënimin me te holla;

1.3. cili nuk e ka të rregulluar obligimin e pasurisë se patundshme që i ka takuar, për te cilën ekziston kontesti gjithëpërfshirës i titulluar, me kërkesën e gjykatës kompetente;

1.4. nëse këtë e kërkojnë shkaqet e mbrojtjes së rendit juridik, sigurisë kombëtare apo shëndetit publik, në pajtim me procedurat dhe garancat të përcaktuara me ligj .

2. Dokumenti i udhëtimit për të huajt mund të konfiskohet në bazë të arsyeve të përcaktuara në këtë nen. Ankesa nuk ka efekt suspendimi. Dokumenti i udhëtimit do të mbahet për aq gjatë sa ekzistojnë arsyet e konfiskimit.

KREU III

VIZAT

Neni 14

Lëshimi i Vizave

1. Viza është aprovim për hyrje dhe qëndrim jo më të gjatë se nëntëdhjetë (90) ditë apo tranzit përgjatë territorit të Republikë së Kosovës.

2. I huaji është i obliguar ta siguroj vizën para hyrjes në Republikën e Kosovës.

3. Bazuar vetëm në vizë i huaji nuk mund të sigurojë punë me pagesë në Republikën e Kosovës

4. Vizat i lëshon misioni diplomatik gjegjësisht zyra konsullare e Republikës së Kosovës ose organet tjera që autorizohen nga qeveria e Republikës së Kosovës.

5. Para lëshimit të vizës, misioni diplomatik apo zyra konsullare ose organet tjera që autorizohen nga qeveria e Republikës së Kosovës janë të obliguara të marrin pëlqimin paraprak të Ministrisë kompetente.

Neni 15 **Vlefshmëria e Vizave**

1. Viza i lëshohet të huajit i cili posedon dokumentin e vlefshëm të udhëtimit.

2. Viza lëshohet në afat vlefshmërie e cila duhet te jete më e shkurtë se sa afati i vlefshmërisë të dokumentit të udhëtimit.

Neni 16 **Llojet e Vizave**

1. Llojet e vizave janë :

1.1. viza hyrëse;

1.2. viza tranzite;

1.3. viza tranzite-ajrore;

1.4. viza grupore.

Neni 17 **Viza e Hyrjes**

1. Viza e hyrjes lëshohet për një apo më tepër hyrje në Republikën e Kosovës.

2. Viza e hyrjes lëshohet me afat vlefshmërie deri në një vit.

3. Qëndrimi i pandërprerë, gjegjësisht zgjatja e përgjithshme e qëndrimeve të njëpasnjëshme të huajit me vizën e hyrjes në Republikën e Kosovës nuk mund të jetë më gjatë se nëntëdhjetë (90) ditë, në fazën kohore prej gjashtë (6) muajsh duke llogaritur nga dita e hyrjes së parë.

4. Viza e hyrjes me afat të vlefshmërisë më të gjatë se një vit jepet me marrëveshje të personelit diplomatik apo përfaqësuesve konsullarë të shtetit të huaj në Republikën e Kosovës.

5. Nëse këtë e kërkojnë nevojat humanitare, arsyet serioze profesionale dhe personale, vizën e hyrjes për një hyrje dhe qëndrim deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë e lëshon organi kompetent për kontrollin e kalimit kufitarë.

Neni 18 **Vizat tranzitore**

1. Viza transite i lëshohet të huajit për një, ose më tepër udhëtime të veçanta nëpërmjet Republikës së Kosovës.
2. Viza transite lëshohet në afat vlefshmërie deri në gjashtë (6) muaj.
3. Në bazë të vizës transite i huaji mundet me rastin e çdo udhëtimit të qëndrojë në Kosovë më së gjati pesë ditë.
4. Viza transite i lëshohet të huajit i cili argumenton se e ka hyrjen e siguar në shtetin e destinimit.
5. Nëse këtë e kërkojnë nevojat humanitare, profesionale, dhe ato personale serioze, vizën tranzitore për një transit mund ta lëshojë organi kompetent në pikën kalimit kufitar.

Neni 19 **Vizat e Tranzitit-Ajror**

1. I huaji i cili gjatë tranzitit-ajrore në aeroportin e Republikës së Kosovës, nuk e lëshon hapësirën tranzite-ajrore nuk i kërkohej viza.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, bazuar në nenin 6.2 të këtij ligji Qeveria e Kosovës mundet që shtetasve të huaj të shteteve të caktuara t'i kërkojë viza tranzite.
3. Të huajit i lëshohet viza tranzitor-ajrore për një apo më tepër kalime nëpërmjet hapësirës tranzite-ajrore me ç'rast të çdo kalimi tranzit mund të qëndrojë më së shumti njëzetekatër (24) orë në zonën e caktuar të aeroportit.

Neni 20 **Viza grupore**

1. Viza grupore i lëshohet grupit prej pesë (5) deri në pesëdhjetë (50) persona për një hyrje apo tranzit nëpër territorin e Republikës së Kosovës.

2. Viza grupore mund t'i lëshohet edhe grupit me numër më të madh të personave, nëse ka të bëjë me grupet e organizuara turistike të cilët në Republikën e Kosovës vijnë në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

3. Në bazë të vizave grupore për një hyrje në shtetin e Kosovës mund të qëndrohet më së tepërmi tridhjetë (30) ditë.

4. Nëse është në interes të Republikës së Kosovës me vlerësimin e institucionit përkatës qeveritar, vizën grupore e lëshon organi kompetent për kontrollimin e kalimit kufitarë.

Neni 21 Procedurat për Lëshimin e Vizave

Procedura dhe mënyra e lëshimit të të gjitha llojeve të vizave nga neni 16 i këtij ligji rregullohet me akte nënligjore.

Neni 22 Vazhdimi i vizave

1. Viza nuk mund të vazhdohet.

2. Përjashtimisht nga paragrafi i mëparshëm, viza e hyrjes vazhdohet në raste urgjente si, humanitare profesionale apo shkaqe personale.

3. Kërkesa për vazhdimin e vizës së hyrjes sipas nenit 22 (2) parashtrohet para organit kompetent i cili vendosë për kërkesën e parashtruar.

Neni 23 Moslëshimi i vizave

1. Viza nuk lëshohet nëse :

1.1. ekzistojnë shkaqet nga neni 29 i këtij ligji;

1.2. i huaji personalisht nuk i përgjigjet ftesës së misionit diplomatik respektivisht zyrës konzulare.

2. Përjashtimisht nga neni 23 (1) i këtij neni, viza i lëshohet për shkaqe humanitare nëse kjo është në interes të Republikës së Kosovës apo në pajtueshmëri me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 24

Kompetencat e Autoritetit për Kontrollin e Kufirit Shtetëror

1. Organi kompetent për kontrollin e kalimit të kufirit shtetëror cakton që të huajit t'i lejohet hyrja vetëm në kalimin e caktuar të kufirit.
2. Organi kompetent për kontrollin e kalimit të kufirit shtetërorë, shkurton afatin e vazhdimit të vizës nëse e verifikon që i huaji nuk posedon mjete të mjaftueshme për tu mbajtur gjatë kohëzgjatjes së vizës.
3. Organi kompetent për kontrollin e kalimit të kufirit shtetëror anulon vizën nëse verifikon ekzistimin e shkaqeve nga neni 29 i këtij ligji.
4. Anulimi i vizës behet me vendim të formës së shkruar, kundër tij lejohet ankesa.

Neni 25

Obligimet e Transportuesve

1. Transportuesi mund ta sjell të huajin në piken e kalimit kufitar nëse i plotëson kushtet e nenit 4 të këtij ligji.
2. Nëse të huajit i është refuzuar hyrja në Republikën e Kosovës, transportuesi që e ka sjellë atë tek kufiri duhet që me kërkesën e organit kompetent kufitar , t'a kthejë të huajin në shtetin nga i cili ka hyrë, në shtetin ku dokumenti i të huajit është lëshuar, apo në ndonjë shtet tjetër që është i gatshëm ta pranojë atë.
3. Nëse transportuesi nuk mund ta kthejë të huajin nga Republika e Kosovës në pajtim me nenin 25.2 duhet që menjëherë dhe me shpenzime të tij/saj të sigurojë transportues tjetër.
4. Transportuesi që e ka sjell të huajin në kufirin shtetëror apo në territorin e Republikës së Kosovës në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni duhet të paguaj shpenzimet e akomodimit dhe kthimit prapa të të huajit.
5. Detyrimet që rrjedhin nga ky nen duhet të zbatohen edhe ndaj transportuesit që bart të huajin në kufirin shtetëror ose brenda territorit të Republikës së Kosovës, i cili është duke kaluar transit ose të cilit i është refuzuar transporti i mëtutjeshëm nga transportuesi tjetër, ose të cilit i është refuzuar hyrja në shtetin e destinacionit dhe është kthyer në Republikën e Kosovës.
6. Organizatori i udhëtimeve turistike apo atyre të punës në Republikën e Kosovës është i obliguar që për të huajta të cilëve i është ofruar shërbimi përkatës, ti mbulojë shpenzimet e largimit nga Republika e Kosovës, nëse të huajit i është ndaluar hyrja apo huaji largohet me dhune nga Republika e Kosovës , dhe nëse këto shpenzime I huaji nuk mund ti mbulojë vetë.

KREU IV

HYRJA DHE DALJA E TE HUAJVE PREJ SHTETIT

Neni 26 Hyrja në shtet

1. I huaji ka hyrë në Republikën e Kosovës atëherë kur ai/ajo ka kaluar kufirin shtetëror, gjegjësisht kur ka kaluar vendin ku bëhet kontrolli kufitar.
2. Mbajtja e të huajve në hapësirën tranzite në aeroport dhe mbajtja e tyre në kalimet kufitare nuk nënkupton hyrjen në Republikën e Kosovës.

Neni 27 Kontrolli Kufitar

Te huajt me rastin e hyrjes dhe daljes nga Republika e Kosovës janë te obliguar t'i nënshtrohen kontrollit të kufirit shtetëror.

Neni 28 Hyrja pa Dokument të Udhëtimit

1. Nëse i huaji vjen për vizite turistike apo afariste ne Republikën e Kosovës e nuk posedon dokumentin e vlefshëm të udhëtimit, organi kompetent për kontrollin e kalimit të kufirit shtetëror i lëshon lejen për kalimin e kufirit, në bazë të dokumentit që dëshmohet identiteti i të huajit, të cilin e ka lëshuar shteti i të cilit i huaji është shtetas.
2. Te huajve ne udhëtim ajror, ujqor mundë t'i lëshohet leja e kalimit te kufirit edhe në bazë te regjistrir te udhëtarëve te cilin e ka vërtetuar personi përgjegjësj.
3. Regjistrimi i udhëtareve përmban emrin dhe mbiemrin vitin e lindjes, shtetësinë dhe numrin e dokumentit te udhëtimit te udhëtarëve, gjegjësisht numrin e ndonjë dokumenti tjetër me te cilin verifikohet identiteti.
4. Leja kufitare e qarkullimit lëshohet ne afat vlefshëmrie deri ne tre (3) muaj.
5. Leja kufitare e qarkullimit sipas këtij neni nuk i lëshohet të huajit nëse ekzistojnë shkaqet nga neni 29 i këtij Ligji.

Neni 29
Ndalesa për Hyrje dhe Ri-Hyrje

1. Hyrja në Kosovë nuk i lejohet të huajit nëse:

1.1 Nuk i plotëson kushtet nga neni 4. të këtij ligji;

1.2 nuk posedon mjete të mjaftueshme për jetesë gjatë kohës së qëndrimit në Republikën e Kosovës si dhe për kthimin në shtetin prej nga ka ardhur apo për udhëtim në vendin e tretë;

1.3 është në transit dhe nuk i plotëson kushtet për hyrje në shtetin e tretë;

1.4 është në fuqi urdhri i depërtimit me ndalesë për ri-hyrje

1.5 nuk posedon vërtetimin për vaksinimin, e vjen nga zona ku mbretëron epidemia e sëmundjeve ngjithëse;

1.6 këtë e kërkojnë shkaqet e mbrojtjes të rendit juridik, sigurisë kombëtare apo shëndetit publik;

1.7 ekziston dyshimi i bazuar që qëndrimi i tij mundë të jetë i lidhur me kryerjen e veprave penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare;

1.8 Evidencat e organit të regjistruara për kryesit e veprave penale

2. Vendimi për deportimin mund të përcaktojë ndalesën e ri-hyrjes së të huajit. Ndalesa e ri-hyrjes regjistrohet në dokumentin e udhëtimit të të huajit. I huaji mund të kërkojë nga gjykata kompetente t'ia kërkojë shkurtimin e kohëzgjatjes së ndalesës së ri-hyrjes pas daljes së tij nga Republika e Kosovës.

3. Qeveria e Republikës së Kosovës përcakton shumën e mjeteve për jetesë sipas paragrafit 1. nën-paragrafit 1.2. të këtij neni.

Neni 30
Kalimi Ilegal i Kufirit

1. Me kalimin ilegal të kufirit shtetëror kuptohet nëse i huaji:

1.1. tenton të kalon kufirin shtetëror jashtë pikës së kalimit kufitar apo kohës të caktuar për kalimin e kufirit shtetëror;

1.2. shmanget apo tenton të shmanget kontrollit kufitare;

1.3. gjatë kalimit të kufirit shtetëror përdorë dokumentin e udhëtimit jo të vlefshëm, të huaj gjegjësisht ndonjë dokument tjetër jo valid;

1.4. zyrtarëve të autorizuar për kontrollin e kalimit të kufirit shtetëror i jep të dhëna të rrejshme;

1.5. hyn në Republikën e Kosovës derisa urdhri për depërtim me ndalesë për ri-hyrje është në fuqi.

Neni 31 **Kufizimi Kohor i Qëndrimit pa Vizë**

Të huajt të cilit për hyrje në shtet nuk i kërkohet viza mund të qëndrojnë në Kosovë më së gjati nëntëdhjetë (90) ditë në periudhën kohore prej gjashtë muajve duke llogaritur prej ditës së parë të hyrjes, nëse me dispozitat këtij ligji apo me marrëveshje ndërkombëtare nuk parashihet ndryshe.

Neni 32 **Largimi i të Huajve**

1. Të huajt mund të largohen lirisht nga Republika e Kosovës.

2. Dalja prej Republikës së Kosovës nuk i lejohet të huajt nëse:

2.1. posedon dokumentet e huaja, të pa vlefshme, respektivisht dokumente jo valide,

2.2. nuk i plotëson kushtet për hyrje në shtetin tjetër;

2.3. ekziston dyshimi i bazuar me qëllim të shmangies së ndjekjes për vepra penale respektivisht nga ndjekja për kundërvajtje, të zbatimit të dënimit, fletarrestim të gjykatës, arrestimit apo kryerjen e obligimeve pronësore juridike,

2.4. këtë e kërkojnë shkaqet e mbrojtjes të rendit kushtetues, sigurisë kombëtare ose shëndetit publik dhe të jetë vendosur nga organi kompetent në pajtim me procedurat e përcaktuara me ligj

3. Të huajt i lejohet dalja prej Republikës së Kosovës kur pushojnë së ekzistuari shkaqet nga paragrafi 2. i këtij neni.

4. Në rastet e refuzimit të hyrjes të huajt në territorin e Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 2.4 të këtij neni, organi kompetent i' a lëshon të njëjtit një vendim me shkrim. I huaji ka të drejtë ankesë mbi këtë vendim pranë Gjykatës kompetente territoriale. Gjykata duhet të nxjerr vendim lidhur me këtë çështje brenda afatit shtatëdhjetë e dy (72) orësh prej momentit të parashtrimit të ankesës e cila mund ta anulojë vendimin dhe të jep urdhër që i huaji të lirohet dhe të lëshojë vendin.

KREU V

QËNDRIMI I TË HUAJVE

Neni 33 Llojet e Qëndrimit

1. Qëndrimi i të huajve në Republikën e Kosovës mund te jete:

- 1.1. qëndrimi deri në nëntëdhjetë (90) ditë;
- 1.2. qëndrimi i përkohshëm;
- 1.3. qëndrimi i përhershëm.

2. Qëndrim deri ne nëntëdhjetë (90) dite nënkupton qëndrimin e të huajit në Republikën e Kosovës pa vizë, me vizë ose me leje qarkullimi kufitare, nëse me dispozitat këtij ligji apo me marrëveshje ndërkombëtare nuk parashihet ndryshe.

Neni 34 Qëndrimi i përkohshëm

1. eja për qëndrim të përkohshëm i jepet të huajit i cili:

- 1.1. ka për qëllim të qëndrojë në Republikën e Kosovës më gjatë, por jo në bazë të asaj për çka i është lëshuar viza;
- 1.2. Për hyrje në Republikën e Kosovës nuk i duhet viza, e ka për qëllim të qëndroj në Kosovë më gjatë se nëntëdhjetë (90) ditë ose për shkaqe të cekura në nenin 39 të këtij ligji;
- 1.3. mendon të qëndroj në Republikën e Kosovës për më gjatë se tridhjetë (30) ditë dhe është i angazhuar në kategorinë e punësimit të përcaktuar në aktin ligjor që rregullon punësimin e të huajve në Republikën Kosovë.

Neni 35 Kushtet për Qëndrimin e Përkohshëm

1. Leja për qëndrim te përkohshëm për here te pare, lëshohet në afate vlefshmërie deri në një vit, nëse me dispozitat e këtij Ligji apo me marrëveshje ndërkombëtare nuk parashihet ndryshe.

2. Leja për qëndrim të përkohshëm shënohet në dokumentin e udhëtimit të të huajit. Afati i vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit duhet patjetër të jetë më së paku tre (3) muaj më e gjatë se sa koha për të cilën lëshohet leja.

3. Përjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, i huaji i cili nuk posedon dokumentin e udhëtimit të vlefshëm, Leja për qëndrim të përkohshëm i vazhdohet me vendim te organit kompetent.

Neni 36

Aplikimi për Qëndrim të Përkohshëm

1. Kërkesën për lëshimin e lejes për qëndrimin të përkohshëm për herë të pare, i huaji e parashtron pranë misionit diplomatik gjegjësisht zyrës konzulare të Kosovës ose organeve tjera që autorizohen nga qeveria e Republikës së Kosovës.

2. Për të huajin të cilit për hyrje në Republikën e Kosovës nuk i kërkohet viza, kërkesën për lëshimin e lejes për qëndrimin e përkohshëm për herë të pare, mundë ta parashtroi edhe pran organit kompetent.

3. Kërkesa për vazhdimin e qëndrimit të përkohshëm i paraqitet organit kompetent më së voni tridhjetë (30) ditë para skadimit të afatit të qëndrimit të përkohshëm.

4. Për kërkesën nga paragrafët 1, 2 dhe 3. të këtij neni vendosë organi kompetent.

5. Në kërkesën nga paragrafët 1, 2. dhe 3. të këtij neni duhet të ceket qëllimi për çka leja kërkohet.

6. Parashtruesi i kërkesës për qëndrim të përkohshëm nuk mund të ndryshoi qëllimin e qëndrimit gjatë kohës së procedurës.

7. Për kërkesën nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni vendosë organi kompetent në pajtim paraprak me Ministrinë në fushëveprimin e së cilës bie edhe qëllimi për çka i huaji kërkon qëndrim.

8. Nëse Ministria nga paragrafi 7. të këtij neni nuk e njofton organin kompetent në afat prej dhjetë (10) ditësh për kërkesën, konsiderohet që është dhënë pëlqim.

Neni 37

Qëllimi i qëndrimit të përkohshëm

1. Qëllimi i qëndrimit te përkohshëm mund te jete:

1.1. qëllim pune;

1.2. studimi dhe shkollimi;

1.3. bashkimi familjar; dhe

1.4. shkaqeve tjera të arsyeshme të caktuara me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 38 **Kërkesa për Qëndrim të Përkohshëm**

1. Të huajit mund ti lejohet qëndrimi i përkohshëm nëse ai/ajo:

1.1. posedon mjete të mjaftueshme materiale për jetesë;

1.2. ka banimin e siguruar;

1.3. ka sigurim shëndetësor;

1.4. qëndrimi i tij nuk është në kundërshtim me nenin 46. të këtij ligji;

1.5. ka paraqitur argumentet mbi arsyshmërinë e qëndrimit të përkohshëm.

2. Nëse aplikimi për qëndrim të përkohshëm është bërë në pajtueshmëri me aplikimin për bashkim familjar, dhe nëse kushtet e parapara me paragrafin 1 të këtij neni gjithashtu paraqiten nga nikoqiri.

3. Krahas kërkesës për qëndrim të përkohshëm për here të pare, i huaji është i obliguar të paraqes vërtetimin që nuk është i dënuar nga shteti në të cilin ka banimin e fundit.

4. Kundër vendimit me të cilin refuzohet kërkesa për lejen e qëndrimit të përkohshëm mund të parashtrahet ankesa në afat prej tetë ditëve prej ditës së pranimit të vendimit.

5. Lidhur me ankesën nga paragrafi 3 të këtij neni vendosë organi kompetent.

Neni 39 **Qëllimet për Qëndrim të Përkohshëm**

1. Të huajit të cilit i është dhënë leja për qëndrim të përkohshëm PR qëllime të caktuara, mund të qëndroj në Kosovë vetëm në pajtim me qëllimin për çka i është dhënë leje qëndrimi i përkohshëm.

2. Të huajit të cilit i është dhënë leja për qëndrim të përkohshëm për qëllim të caktuar, përveç të huajit i cili qëndron me qëllim të punës sezonale dhe i huaji i cili është i angazhuar në kategorinë e veçantë të punësimit të përcaktuar në aktin ligjor që rregullon punësimin e të huajve në Republikën Kosovës, e që ka për qëllim të qëndroj në Republikën e Kosovës më tepër se tridhjetë (30) ditë mund të parashtrahet kërkesën për leje qëndrim mbi baza tjera.

Neni 40
Qëndrimi i Përkohshëm për qëllime pune

1. Qëndrimi i përkohshëm për qëllime pune i lejohet të huajit:

1.1 të cilit i është lëshuar leja e punës,

1.2 të cilit nuk i duhet leja e punës, por ka për qëllim të qëndroi në Kosovë më gjatë se tridhjetë (30) ditë nëse i plotëson kushtet tjera të parashikuara me dispozitat e këtij ligji.

2. Leje qëndrimi të përkohshëm me qëllim të punës i lëshohet të huajit në afatin që i është lëshuar edhe leja e punës.

3. Lidhur me kërkesën e leje qëndrimit të përkohshëm me qëllim pune vendosë organi kompetent sipas vendqëndrimit të të huajit.

Neni 41
Rregullimi i Punësimit të të Huajve

Punësimi i të huajve në Republikën e Kosovës do të rregullohet me akt të veçantë ligjor.

Neni 42
Qëndrimi i Përkohshëm për Qëllime Edukimi

1. Kërkesa për lëshimin e lejes për qëndrim të përkohshëm me qëllim të shkollimit, shërbimit vullnetar, trajnimit pa pagesë, është i obliguar që përveç kushteve të parapara në nenin 38 të këtij ligji, t'i bashkëngjis edhe certifikatën e lëshuar nga institucioni legjitim që i pranojnë në Republikën e Kosovës.

2. Leja për qëndrim të përkohshëm në kuptimin e shkollimit apo studimeve mundë të vazhdohet më se gjatë deri në dy vjet pas skadimit të afatit të caktuar me rregulla për kohën e zgjatjes së shkollimit respektivisht studimit.

Neni 43
Qëndrimi i Përkohshëm me Qëllim të Bashkimit Familjar

1. Kërkesën për lëshimin e lejes për qëndrim të përkohshëm me qëllim të bashkimit familjar, ka të drejtë ta paraqes i huaji-anëtari i ngushtë i familjes së shtetasit të Republikës së Kosovës, të huajit të cilit i është lejuar qëndrimi i përhershëm apo përkohshëm ose i huaji i cili ka statusin e azilantit.

2. Anëtarët e familjes së ngushtë, në kuptimin e dispozitave të këtij ligji, konsiderohen bashkëshortët, fëmijët e mitur të cilët nuk kanë krijuar familjet e tyre si dhe prindërit e fëmijëve

të mitur. Anëtar i familjes së ngushtë mund të konsiderohet edhe i afërmi tjetër, i adoptuar ose adoptuesi, nëse ekzistojnë shkaqe të veçanta personale apo humanitare për bashkimin e familjes në Republikën e Kosovës.

3. Në bazë të lejes për qëndrim të përkohshëm, me qëllim të bashkimit familjar i huaji nuk mund të punojë në Republikën e Kosovës.

Neni 44

Vazhdimi i Qëndrimit të Përkohshëm me Qëllim të Bashkimit Familjar

1. Të huajit, anëtar të ngushtë të familjes së shtetasit të Republikës së Kosovës, pas kërkesës mund t'i vazhdohet qëndrimi i përkohshëm në afat deri tri vite gjegjësisht deri në plotësimin e kushteve për lëshimin e lejes për qëndrim të përhershëm.

2. I huaji, anëtar i ngushtë i familjes së qytetarit të Republikës së Kosovës, mund të kërkojë vazhdimin e qëndrimit të tij/saj të përkohshëm edhe në rastin kur parashtruesi i kërkesës së tij/saj për qëllime të bashkimit familjar, me qëndrim të përkohshëm, ka vdekur ose martesë e tyre që ka zgjatur së paku tri vite në Republikën e Kosovës ka përfunduar.

Neni 45

Qëndrimi i Përkohshëm për Fëmijët e Porsalindur

1. Për fëmijën e lindur në territorin e Republikës së Kosovës i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës, nuk kërkohet leje qëndrimi deri sa të mbush një muaj jetesë.

2. Pas një muaji qëndrimi të përkohshëm, leja për qëndrim të përkohshëm i jepet fëmijës sipas detyrës zyrtare, kurse i vazhdohet për aq kohë për të cilën është lejuar qëndrimi i përkohshëm i njërit prind apo kujdestarit të femiut.

Neni 46

Ndërprerja e Qëndrimit të Përkohshëm

1. I huaji i cili qëndron në Republikën e Kosovës, deri në nëntëdhjetë (90) ditë dhe të huajit të cilit i është lejuar qëndrimi i përkohshëm, organi kompetent i ndërpret qëndrimin nëse ai/ajo:

1.1 vërteton ekzistimin e shkaqeve nga neni 29 të këtij ligji;

1.2 punon në Republikën e Kosovës pa leje të vlefshme pune, gjegjësisht në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji;

1.3 qëndron në Republikën e Kosovës në kundërshtim me qëllimin për çka i është dhënë leja;

1.4 cenon rendin publik apo vlerat tjera demokratike të shoqërisë të mbrojtura me ligj.

2. Më rastin e caktimit të afatit për lëshimin e Republikës së Kosovës, të huajit duhet të merret parasysh koha e nevojshme për të, cilën ai mund ta përmbushë këtë obligim, mirëpo afati nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) ditë.

3. Me rastin e anulimit të vendimit për qëndrimin e të huajit, duhet t'i merret parasysh kohëzgjatja e qëndrimit në atë shtet dhe rrethanat personale, familjare, ekonomike e të tjera.

4. Anulimi i qëndrimit shënohet në dokumentin e udhëtimit të të huajit.

Neni 47

Ekzekutimi i Revokimit të Qëndrimit të Përkohshëm

1. Organi kompetent ndërpret qëndrimin e të huajit i cili qëndron në Republikën e Kosovës dhe të huajit që i është lejuar qëndrimi deri në nëntëdhjetë (90) ditë apo qëndrimi i përkohshëm dhe revokimi ekzekutohet menjëherë nëse

1.1. të huajit i është shqiptuar urdhri i deportimit me apo pa ndalesë për ri-hyrje,

1.2. i është anuluar qëndrimi i përkohshëm i tij/saj,

1.3. skadon e afati për të cilin qëndrimi i përkohshëm i është lejuar.

Neni 48

Qëndrimi i përhershëm

1. Qëndrimi i përhershëm i lejohe të huajit i cili:

1.1 deri në ditën e paraqitjes së kërkesës për qëndrim të përhershëm, ka katër vite qëndrim të përkohshëm pa ndërprerë.

1.2. ka tre vite bashkëshortësie në vazhdimësi me shtetasin e njëjtë të Republikës së Kosovës apo me të huajin me leje qëndrimi të përhershëm.

2. Personit të mitur me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës i lejohe qëndrimi i përhershëm nëse njeri nga prindërit është i huaji me leje qëndrimi të përhershme, me pëlqimin e prindit tjetër.

3. Përrjashtimisht, qëndrimi i përhershëm i lejohe edhe të huajve të tjerë me qëndrim të përkohshëm për shkaqe humanitare apo nëse kjo është në interes të Republikës së Kosovës për ta bërë atë.

4. Organi kompetent përcakton njohjen e qëndrimit të përhershëm sipas paragrafit 3. të këtij neni.

5. Kohën të cilën i huaji e ka kaluar në vuajtjen e dënimit me burg nuk i llogaritet në kohën që i duhet për lejimin e qëndrimit të përhershëm, përveç në rastet kur personi përfundimisht lirohet ose kur aktvendimi përfundimtar është anuluar.

Neni 49

Kërkesa për Qëndrim të Përhershëm

1. Kërkesa për dhënien e lejes për qëndrim të përhershëm parashtrohet pran organit kompetent sipas vend qëndrimit të të huajit.

2. Kundër vendimit të organit kompetent nuk është e lejuar ankesa, mirëpo mund të ngritët kontesti juridik.

3. Leja e qëndrimit të përhershëm vendoset në dokumentin e udhëtimit të të huajit.

Neni 50

Refuzimi i Qëndrimit të Përhershëm

1. Qëndrimi i përhershëm nuk i lejohet të huajit i cili:

1.1. ka qenë i dënuar për vepër penale brenda ose jashtë Kosovës;

1.2. nuk posedon mjete materiale për jetesë;

1.3. nuk ka banim të siguruar ,

1.4. nuk ka sigurim shëndetësor;

1.5. paraqet rrezik ndaj rendit juridik, sigurisë kombëtare ose shëndetit publik.

2. Dënimi për vepër penale në kuptim të paragrafit 1.1. të këtij neni nuk përfshin:

2.1 dënimin për vepër penale me gjobë ose deri në gjashtë muaj heqje lirie, nëse gjykata ka shqiptuar dënimin me kusht;

2.2. dënimin për vepër penale të shqiptuar nga një gjykatë e huaj nëse vepra në fjalë nuk konsiderohet vepër penale në Republikën e Kosovës ose nëse dënimi është shqiptuar në bazë të një procedure e cila nuk është konform standardeve evropiane të së drejtës penale, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore; dhe

2.3. dënimin për vepër penale të shlyer në mënyrë legjitime nga evidenca e të dënuarve.

Neni 51 **Revokimi i Qëndrimit të Përhershëm**

1. Organi kompetent e anulon qëndrimin e përhershëm të huajit nëse:

1.1 është i dënuar për vepra penale me dënim pa kusht dhe të plotfuqishëm prej gjashtë muaj e më tepër;

1.2 këtë e kërkojnë arsyet e mbrojtjes së rendit kushtetues, sigurisë kombëtare apo shëndetit publik.

2. Me rastin e caktimit të afatit për largimin nga shteti, organi kompetent merr parasysh kohën për të cilën i huaji mund të përgatitet, mirëpo afati nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) ditë.

3. Me rastin e anulimit të qëndrimit, të huajit duhet të merret parasysh kohëzgjatja e deriatëhershme e qëndrimit dhe rrethanat personale, ekonomike, familjare dhe rrethanat e tjera.

4. Anulimi i qëndrimit vendoset në dokumentin e udhëtimit të huajit.

Neni 52 **Ekzekutimi i Revokimit të Qëndrimit të Përhershëm**

1. Organi kompetent ndërpret qëndrimin e të huajit të cilit i është lejuar qëndrimi i përhershëm dhe e ekzekuton menjëherë nëse:

1.1 të huajit i është shqiptuar urdhri i deportimit me apo pa ndalesë për ri-hyrje;

1.2 organi kompetent e konstaton që i huaji është shpërngulur, ose pandërprerë qëndron jashtë Republikës së Kosovës, me gjatë se gjashtë muaj, e për këtë nuk ka njoftuar organin kompetent;

1.3 i është anuluar qëndrimi i përhershëm.

2. Në rastin nga paragrafi 1.2. të këtij neni, vendimin për anulimin e qëndrimit të përhershëm nxjerr organi kompetent.

3. Organi kompetent mund të merr vendim edhe pa dëgjimin paraprak të huajit.

KREU VI

QËNDRIMI I PALIGJSHËM

Neni 53

Qëndrimi i Paligjshëm

1. Konsiderohet se i huaji qëndron në mënyrë të paligjshme në Republikën e Kosovës, nëse nuk posedon vizën apo lejen e qëndrimit nga neni 4. i këtij ligji
2. I huaji i cili qëndron në mënyrë të paligjshme në Republikën e Kosovës duhet menjëherë apo në afatin që i është caktuar t'a lëshojë territorin e Republikës së Kosovës.
3. Konsiderohet që i huaji e ka lëshuar Kosovën, në momentin e kalimit të kufirit shtetëror.
4. I huaji i cili ka paraqitur me kohë kërkesën për vazhdimin e qëndrimit të përkohshëm mund të qëndroj në Kosovë deri në marrjen e vendimit të plotfuqishëm.

Neni 54

Refuzimi dhe Mbajtja në Kufirin Shtetëror

Të huajit mund t'i refuzohet hyrja në kufi për shkaqe sigurie dhe të sigurohet largimi nga territori i Republikës së Kosovës dhe ai/ajo mund të mbahet në objektet e organit kompetent jo më gjatë se dymbëdhjetë (12) orë.

Neni 55

Urdhri për largim

1. Të huajit i cili është gjetur duke qëndruar në mënyrë të paligjshme në Republikën e Kosovës, organi kompetent i cakton atij/asaj afatin dhe kohën e caktuar që ai/ajo obligohet ta lëshojë territorin e Republikës së Kosovës, pikën e kalimit kufitar ku ai/ajo do ta lëshojë vendin dhe i'a bën të qartë obligimin e tij/saj që të lajmërohet të organi i autorizuar për kontrollin e kufirit shtetëror gjatë largimit nga territori i Republikës së Kosovës.
2. Me rastin e caktimit të afatit për lëshimin e shtetit, organi kompetent duhet ta ketë në konsideratë kohën për të cilën i huaji mund ta bëjë lëshimin, por afati nuk guxon të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) ditë.
3. Ankesa kundër vendimit mbi caktimin e afatit për lëshimin e shtetit nuk ndalon ekzekutimin e vendimit.

4. Afati për lëshimin e Republikës së Kosovës numërohet prej ditës së dorëzimit të vendimit të urdhrin për largim.

5. I huaji i cili nuk e ka lëshuar Republikën e Kosovës brenda afatit të caktuar në urdhrin për largim, të huajt mund t'i caktohet një datë tjetër për largim me kërkesë të tij/saj apo sipas detyrës zyrtare të organit kompetent.

Neni 56

Rrethanat që merren parasysh kur të merret Vendimi i Urdhërit për Largim

1. Me rastin e vendimit mbi urdhrin për largim të të huajt për ta lëshuar Republikën e Kosovës, organi kompetent merr parasysh kohën e qëndrimit, si dhe rrethanat personale, ekonomike, familjare dhe rrethanat tjera të të huajt.

2. Urdhri për largim shënohet në dokumentin e udhëtimit të të huajt.

Neni 57

Detyrimet e Organeve Tjera Shtetërore

1. Organet shtetërore, duhet që pa vonese të informojnë organin kompetent për qëndrimin e paligjshëm të të huajt në Republikën e Kosovës.

2. Organi i cili kundër të huajt ka inicuar procedurën për kundërvajtje apo për vepra penale për të cilat ndiqet sipas detyrës zyrtare, obligohet që pa vonesë të informoi organin kompetent.

KREU VII

DEPORTIMI I TË HUAJVE

Neni 58

Ekzekutimi i Deportimit

1. I huaji mund të deportohet, me apo pa ndalesë të ri-hyrjes, me urdhër të gjykatës kompetente nëse ai/ajo nuk i përmbahet urdhrin për largim të lëshuar nga organi kompetent sipas nenit 55 paragrafi 1.

2. Organi kompetent duhet të ekzekutojë vendimin e gjykatës kompetente për deportimin e të huajt i cili ilegalisht qëndron në Republikën e Kosovës dhe i cili nuk e lëshon Republikën e Kosovës sipas nenit 55 paragrafi 1 të këtij ligji.

3. Të huajit që i është shqiptuar urdhri për deportim me apo pa ndalesë të hyrjes duhet detyrimisht dhe menjëherë të largohet nga territori i Republikës së Kosovës dhe në të njëjtën mënyrë veprohet edhe me të huajin i cili duhet të kthehet në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare.

Neni 59

Mos-Kthimi i Të Huajve për Shkak të Kërcënimit

1. Të huajt nuk duhet të dëbohen ose të kthehen (parimi i moskthimit) në asnjë mënyrë në shtete ose kufijtë e territoreve ku jeta ose liria e tij ose e saj do të rrezikoheshin për shkak të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të veçantë shoqëror ose mendimit politik.
2. Të drejtat e përcaktuara në nenin 59.1, megjithatë nuk mund të zbatohen ndaj të huajit për të cilin ka arsye të forta se ai është i rrezikshëm për sigurinë e shtetit në të cilin ai/ajo është apo ka qenë i/e dënuar me vendim të plotfuqishëm për krim të rëndë që paraqet rrezik të vazhdueshëm për qytetarët e atij shteti.
3. Personi nuk mund të dëbohet apo kthehet në asnjë mënyrë në shtetin tjetër kur ekzistojnë arsye të forta për të besuar që ai/ajo do të jetë në rrezik për t'iu nënshtruar torturës apo trajtimeve jo njerëzore dhe degraduese.

Neni 60

Ndalimi dhe Mbajtja e të Huajit

1. Të huajit mund t'i refuzohet hyrja në kufi për shkaqe të sigurisë publike. Për të siguruar largimin e të huajit nga territori i Republikës së Kosovës i huaji mund të mbahet në objektet e organit kompetent jo më tepër se dymbëdhjetë (12) orë.
2. Të huajit të cilit nuk mund t'i verifikohet identiteti, nuk ka vizë të vlefshme, nuk ka leje qëndrimi apo nuk mund të deportohet sipas urdhrit paraprak për deportim, mund të mbahet. I huaji i mbajtur sipas këtij neni mund të mbahet në Qendrën e pranimit për të huaj të organit kompetent (në tekstin e mëtejshëm: Qendra).
3. I huaji i cili për shkaqe shëndetësore, nevojave tjera të veçanta apo arsyeve tjera nuk është e mundur të vendoset në Qendër, vendoset në ndonjë vend tjetër me standarde të pranueshme dhe adekuate.
4. Meshkujt dhe femrat e sistemuar në Qendrën e Pranimit apo në vende tjera në pajtim me dispozitat e këtij ligji, do të vendosen në hapësira të ndara. Personat në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare do të vendosen ndaras nga të rriturit, me përjashtim të anëtarëve të familjes së ngushtë të cilët duhet të vendosen së bashku. Fëmijët do të marrin tërë asistencën e duhur përkitazi me moshën e tyre dhe do të trajtohen në pajtim me dispozitat dhe parimet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve të vitit 1989.

5. Anëtarët e komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, të Komisarariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë dhe Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, do të kenë qasje të papenguar, e cila nuk do të nënshtrohet asnjë forme të autorizimit, në Qendër dhe vendet tjera kudo që ndonjë person mbahet në pajtim të dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera përmes të cilëve zbatohen dispozitat e këtij ligji.

6. Organi kompetent do të jetë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të cekura në këtë nen.

Neni 61 **Mbajtja e të huajit**

1. I huaji fillimisht mund të mbahet jo më gjatë se nëntëdhjetë (90) ditë në Qendër derisa ai/ajo të deportohet.

2. Pas skadimit të afatit fillestar nëntëdhjetë (90) ditor, me kërkesë të organit kompetent i huaji mund të mbahet, apo të kthehet në Qendër edhe për nëntëdhjetë (90) ditë tjera pas vendimit të gjykatës kompetente, nëse:

2.1. procedura e përcaktimit të identitetit të tij/saj ose grumbullimi i dokumenteve personale të kërkuara është në vazhdim;

2.2. këtë e kërkojnë shkaqet e sigurisë;

3. Në asnjë rrethanë i huaji nuk mund të mbahet për më tepër se njëqindetëdhjetë (180) ditë në Qendër.

4. I huaji mund të lirohet në çdo kohë nga Qendra pas vendimit të gjykatës kompetente nëse nuk ka arsye për deportimin tij/saj

Neni 62 **Kushtet për mbajtje të të huajit**

1. Gjate kohës së mbajtjes në Qendër i huaji është i obliguar t'i përmbahet rregullave të banimit të Qendrës, dhe nuk i lejohet të largohet pa leje.

2. I huaji për të cilin ekziston baza e arsyeshme që nuk do t'i përmbahet rregullave të Qendrës dhe/apo do të provojë të largohet nga Qendra pa leje ai/ajo do të mbahet nën kushtet e mbikëqyrjes së shtuar brenda Qendrës.

Neni 63 **Vendimi për mbajtjen e të huajit**

1. Mbajtjen në Qendër e cakton me vendim gjykata kompetente.

2. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit për mbajtje.

Neni 64
Ndërprerja e Mbajtjes së të Huajit në Qendër

1. Mbajtja e të huajit ne Qendër ndërpritet me:

- 1.1. largimin e të huajit nga shteti,
- 1.2. kalimin e kohës sipas nenit 61. të këtij ligji,
- 1.3. në çfarëdo kohe me vendim të gjykatës kompetente.

Neni 65
Qëndrimi e përkohshme e të Huajit

1. Qëndrimi i përkohshëm ne Kosovë i lejohe të huajit, i cili nuk mund të deportohet nga Republika e Kosovës.
2. Organi kompetent prezencën e përkohshme e lejon dhe e vazhdon deri në gjashtë muaj ne bazë te kërkesës se të huajit apo sipas detyrës zyrtare.

Neni 66
Kufizimi i lëvizjes së të huajit me prezencë të përkohshme

1. Te huajit me prezencë të përkohshme në Republikën e Kosovës mund t'i kufizohet lëvizja vetëm ne Komunën e caktuar apo në zonën e përcaktuar gjeografike brenda Komunës , dhe mund t'i caktohet lajmërimi i obliguar ne stacionin me te afërt policor. Kufizimi i lëvizjes dhe lajmërimi i obliguar mund te zgjasë deri ne gjashtë muaj.
2. Te huajit te cilit i është lejuar prezenca e përkohshme organi kompetent i cakton adresën e banimit.
3. Te huajit te cilit i është lejuar prezenca e përkohshme nuk i ndërpritet dhe nuk i ndryshohet obligimi për lëshimin e Republikës së Kosovës.
4. Prezenca e përkohshme shënohet ne dokumentin i udhëtimit te të huajit, ndërsa i huaji i cili nuk posedon dokumentin e udhëtimit, i lëshohet dokumenti me fotografi.

Neni 67
Ndërprerja e Prezencës së Përkohshme

1. Prezenca e përkohshme ne Republikën e Kosovës ndërpritet me:
 - 1.1. largimin e te huajit prej shtetit;
 - 1.2. skadimin e afatit te vlefshmërisë te prezencës se përkohshme;
 - 1.3. anulimin e prezencës.
2. Prezenca e përkohshme mund te anulohet nëse:
 - 2.1. shkaqet për te cilat kërkesa e pare për prezencë të përkohshme pushojnë së ekzistuari;
 - 2.2. I huaji I thyen ndalesat e parapara ne nenin 66.

Neni 68
Mbajtja e të Miturit të Huaj

1. I huaji i mitur, vendoset ne Qendër se bashku me familjen e tij/saj të ngushtë dhe/apo kujdestarit, përjashtimisht nëse për te miturin është me i përshtatshëm ndonjë akomodim tjetër.
2. Te huajit të mitur më te ri se 16 vjet në rastet e arsyeshme mund t'i caktohet mbikëqyrja e shtuar brenda Qendrës vetëm në praninë e familjes së ngushtë apo kujdestarit të tij/saj.

Neni 69
Pagimi i Shpenzimeve lidhur me mbajtjen në Qender

1. I huaji është i obliguar t'i bart shpenzimet e tij/saj te banimit ne Qendër dhe shpenzime tjera te cilat krijohen me rastin e deportimit.
2. Shpenzimet në lidhje me mbajtjen dhe deportimin e te huajit qe nuk ka mjete financiare i bartë punëdhënësi I fundit i cili ka punësuar te huajin në Republikën e Kosovës pa leje adekuate si dhe personi i cili është i obliguar t'i mbulojë shpenzimet për te huajin gjatë kohës se qëndrimit ne Republikën e Kosovës brenda 4 viteve pas hyrjes së tij/saj në Republikën e Kosovës. Shpenzimet lidhura me mbajtjen dhe deportimin e të huajit pa mjete financiare duhet të paguhen Brenda 3 muaj pas vendimit të gjykatës kompetente.
3. Shpenzimet te cilat është e pa mundur te paguhen ne pajtueshmëri me paragrafët 1. dhe 2. te këtij neni paguhen nga organi kompetent.

Neni 70
Konfiskimi i mjeteve

1. Organi kompetent te huajin te cilin e largon me dhunë mund t'i merr mjetet financiare dhe ti paguaj shpenzimet ne bazë te nenit 69 paragrafi 1 te këtij Ligji. Procesi i konfiskimit nuk duhet ta lë të huajin pa mjete për nevoja elementare.
2. Për mjetet e marra financiare lëshohet vërtetimi.
3. Për zbatimin e sigurte te largimit me dhunë, te huajit mund ti merren përkohësisht dokumentet e udhëtimit dhe dokumente tjera si dhe bileta e udhëtimit. Për mbajtjen e përkohshme te dokumenteve dhe mjeteve lëshohet vërtetimi adekuat.

KREU VIII

DOKUMENTET PËR VERIFIKIMIN E IDENTITETIT

Neni 71
Vërtetimi i Identitetit të të Huajit

1. I huaji tregon identitetin e tij me: dokumentin e udhëtimit, letërnjoftim për te huajin, letërnjoftim te posaçëm si dhe me dokumente tjera te cilat përmbajnë fotografinë.
2. I huaji është i obliguar te bartë njërin prej dokumenteve të parapara në paragrafin 1 të këtij neni dhe ne rast se i kërkohet nga personi zyrtar, duhet ti tregojë dokumentin me te cilin e verifikon identitetin e tij dhe lejen me te cilën tregon legalitetin e qëndrimit ne Republikën e Kosovë.
3. Te huajit nuk i lejohet qe dokumentin e tij/saj ti ofroj tjetrit për tu shërbyer me te, respektivisht nuk i lejohet te shërbehet me dokumente te pavlefshëm ose me dokument te huaj sikurse te jenë te tij/saj.
4. I huaji është i obliguar qe te shërbehet me emrin e tij personal i cili është i shënuar në njërin nga dokumentet e tij/saj të parapara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 72
Letërnjoftimi për të Huaj

1. Letërnjoftimi për te huaj i lëshohet te huajit te cilit i është lejuar qëndrimi i përhershëm apo qëndrimi i përkohshëm në Republikën e Kosovës.

2. I huaji i cili është anëtar i misionit diplomatik gjegjësisht zyrës konsullare te shtetit te huaj ose anëtar i ndonjë misioni tjetër e qe ka statusin diplomatik në Republikën e Kosovës i lëshohet letërnjoftimi i veçantë.

Neni 73 **Lëshimi i Letërnjoftimit**

Letërnjoftimin nga neni 72 paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji e lëshon organi kompetent.

Neni 74 **Vlefshmëria e Letërnjoftimit**

1. Letërnjoftimi për te huajin te cilit i është lejuar qëndrimi i përhershëm, lëshohet ne afat vlefshmërie prej pesë viteve.
2. Letërnjoftimi për te huajin te cilit i është lejuar qëndrimi i përkohshëm i lëshohet ne përputhje me afatin e qëndrimit te përkohshëm të tij/saj.

Neni 75 **Kërkesa për pajisje me letërnjoftim**

1. Kërkesën për pajisje me letërnjoftim për te huaj, mund ta paraqes i huaji i cili ka mbushur gjashtëmbëdhjetë (16) vite.
2. I huaji te cilit i është lejuar qëndrimi i përhershëm, është i obliguar qe ne afat prej tridhjetë (30) ditësh prej ditës se vendosjes, te paraqesë kërkesën për pajisje me letërnjoftim për te huaj.

Neni 76 **Ndërrimi i Letërnjoftimit**

1 I huaji është i obliguar që letërnjoftimin për te huaj te ndërroi ne raste te:

1.1. ndryshimit te te dhënave ne letërnjoftim, kur është e dëmtuar apo e vjetruar ne atë mase sa nuk mund te verifikoj identitetin e tij/saj,

1.2. kur fotografia ne letërnjoftim nuk tregon pamjen e tij te vërtetë,

2. I huaji është i obliguar që në afat prej tetë ditësh prej ditës se paraqitjes se shkaqeve nga paragrafi 1. i këtij neni, te paraqes kërkesën pranë organit kompetent për ndërrimin e letërnjoftimit për te huaj.

Neni 77
Kthimi i Letërnjoftimit të të Huajit

1. I huaji është i obliguar që letërnjoftimin t'ia kthej organit kompetent nëse:

- 1.1. ndryshohet vendqëndrimi i të huajit;
- 1.2. i është ndërprerë qëndrimi, ne pajtim me nenin 46. ose/dhe 51. te këtij ligji;
- 1.3. fiton shtetësinë së Republikës së Kosovës;

Neni 78
Humbja e Dokumentit të Identifikimit

1. I huaji është i obliguar që menjëherë te lajmërojë organin kompetent për vjedhjen apo humbjen e dokumentit siç është përcaktuar në neni 72. te këtij ligji.

2. Organi kompetent është i obliguar të lëshojë vërtetimin mbi rrethanat e humbjes apo vjedhjes se dokumentit nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. I huaji i cili ka humbur dokumentin e udhëtimit të Republikës së Kosovës apo në ndonjë mënyrë tjetër ka mbetur pa dokument ose letërnjoftim për te huaj jashtë Republikës së Kosovës, është i obliguar që menjëherë ta lajmëroj misionin diplomatik më te afërm, gjegjësisht zyrën konsullare të Republikës së Kosovës.

Neni 79
Mbajtja e Dokumentit

1. Organi kompetent përkohësisht mund të mban dokumentin e të huajit nëse:

- 1.1. është e nevojshme për verifikimin e identitetit të të huajit;
- 1.2. ekzistojnë dyshime se ka kryer vepër penale ose mbajtja e dokumentit është bere me vendim te Gjykatës kompetente;
- 1.3..Nuk ka kryer obligimin pronësoro juridik sipas kërkesës se Gjykatës kompetente;
- 1.4. Nëse këtë e kërkojnë shkaqet për mbrojtjen e rendit kushtetues, sigurisë kombëtare apo shëndetit publik.

2. Dokumenti nga paragrafi 1 i këtij neni mbahet derisa te ekzistojnë arsyet për mbajtjen e tij.

3. Për mbajtjen e përkohshme te dokumentit i lëshohet dëshmi nga organi kompetent.

4. I huaji ka te drejte ankese kundër vendimit për mbajtjen e përkohshme te dokumentit dhe ankesa duhet te vendoset nga ana e Gjykatës me kompetencë territoriale.

KREU IX

VENDQËNDRIMI DHE VENDBANIMI I TE HUAJVE

Neni 80 Vendbanimi

1. Vendqëndrimi është vendi ku i huaji vendoset për qëndrim te përkohshëm deri ne nëntëdhjetë (90 ditë.
2. Vendbanimi është vendi ku i huaji vendoset me lejen e qëndrimit te përhershëm me qëllim që aty te jetoj përherë.

Neni 81 Ndryshimi i Adresës së Vendbanimit

1. I huaji me qëndrim të përkohshëm ne Republikën e Kosovës, është i obliguar ta lajmëroj vendbanimin dhe ndryshimin e adresës se banimit pranë organit kompetent në afat prej tre ditësh nga dita e hyrjes në territorin e Republikës së Kosovës, gjegjësisht që nga dita e ndryshimit të adresës së banimit.
2. I huaji me qëndrim të përhershëm në Kosovë është i obliguar që ta lajmërojë vendbanimin dhe ndryshimin e adresës së banimit pran organit kompetent në afat prej tetë ditëve që nga dita e ndryshimit te adresës së banimit.
3. I huaji nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni është i obliguar të ç’lajmërojë vendbanimin gjegjësisht vendqëndrimin para se ta lëshojë Republikën e Kosovës.

Neni 82 Lajmërimi i vendbanimit

1. Institucionet shëndetësore apo punonjësit shëndetësor te praktikës private te cilët pranojnë te huajt për shërim, obligohen ta lajmërojnë organin kompetent brenda njëzetekatër (24) orëve nga dita e pranimit të tij/saj.
2. Personat fizik dhe juridik të cilët ofrojnë akomodim të të huajve, por edhe personat tek të cilët vijnë te huajt për vizite në Republikën e Kosovës, janë te obliguar që te lajmërojnë organin kompetent për pranimin e te huajve brenda dymbëdhjetë (12) orëve nga pranimi i të huajit.

3. I huaji i cili nuk shfrytëzon akomodimin nga paragrafi 2. i këtij neni, obligohet që brenda njëzetekatër (24) orëve ta lajmëroi banimin te organi kompetent.
4. Ofruesi i akomodimit të përcaktuar në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni duhet ta lajmëroi organin kompetent për pranimin e të huajit.
5. Ofruesi i akomodimit duhet të njoftojë organin kompetent brenda dymbëdhjetë (12) orëve për vendqëndrimin e të huajit.
6. Dispozitat nga paragrafi 1 deri në 4 të këtij neni kanë të bëjnë me të huajt te cilët qëndrojnë në Republikën e Kosovës deri në nëntëdhjetë (90) ditë.

Neni 83

Evidenca e të Huajve

1. Personat fizik dhe juridik te cilët ofrojnë akomodim për të huajt, obligohen që të mbajnë evidencën për të huajt e akomoduar.
2. Personat nga paragrafi 1. i këtij neni janë te obliguar ta ruajnë evidencën mbi të huajt më së paku tre vite nga dita e përmbylljes së saj.
3. Personat nga paragrafit 1. i këtij neni obligohen që me kërkesë zyrtare të zyrtarit të autorizuar të organit kompetent, t'i japin për shikim të dhënat nga evidenca e te huajve.

KREU X

MBLEDHJA E TE DHËNAVE PERSONALE

Neni 84

Mbledhja dhe Ruajtja e të Dhënave Personale

1. Organi kompetent mbledh te dhënat personale për të huajt nga organet shtetërore, personat fizik dhe juridik si dhe prej vet të huajit nëse:
 - 1.1. është në interes të të huajit, e supozohet që ai/ajo nuk do të kundërshtoi ose
 - 1.2. është e nevojshme për verifikimin e te dhënave për te huajin.
2. Te dhënat e mbledhura do te përdoren në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e te Dhënave personale.

KREU XI

LËVIZJA E TE HUAJVE NË UNIFORMË

Neni 85

Lëvizja me Uniformë të Huaj Ushtarake

1. Gjatë kohës së qëndrimit të të huajit në Republikën e Kosovës mund të lëvizin ne uniformë të huaj ushtarake në publik nëse:

1.1. ai/ajo qëndron në Republikën e Kosovës si pjesëtar i misionit diplomatik, zyrës konsullare të shtetit të huaj apo ndonjë misioni tjetër të huaj që gëzon status diplomatik në Republikën e Kosovës në cilësinë e këshilltarit apo përfaqësuesit ushtarak.

1.2. ai/ajo është pjesëtar i misionit ushtarak apo delegacionit të huaj ushtarak në Republikën e Kosovës në një vizitë zyrtare;

1.3. ai/ajo është duke vijuar programin arsimor në shkollë apo institucion ushtarak;

1.4. ai/ajo është duke kaluar transit në Republikën e Kosovës si pjesëtar i misionit të huaj ushtarak apo delegacionit me pasaportë zyrtare ose diplomatike;

1.5. ai/ajo është pjesëmarrës/e në ushtrime ushtarake apo trajnime.

2. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës në pajtim me Ministrinë e Punëve të Brendshme mund t'u lejojë bartjen e uniformës së huaj ushtarake edhe të huajve tjerë gjatë kohës së qëndrimit të tyre në Republikën e Kosovës.

Neni 86

Lëvizja me Uniformë Policore të Huaj

1. Të huajt mund të bartin uniformen e huaj policore ose doganave nëse:

1.1. ai/ajo është pjesëtar i delegacionit të huaj policor apo doganor që qëndron në vizitë zyrtare në Republikën e Kosovës;

1.2 ai/ajo kryen shërbimin në kontrollin e përbashkët të kalimit të kufirit shtetëror në pjesën e kufirit që i takon Republikës së Kosovës;

1.3 ai/ajo është duke vijuar programin arsimor në shkollë apo institucion policor;

1.4 ai/ajo është duke kaluar tranzit në Republikën e Kosovës si pjesëtar i misionit të huaj policor, doganor apo delegacionit me pasaportë zyrtare ose diplomatike,

KREU XII

MBIKËQYRJA

Neni 87

Mbikëqyrja dhe Inspektimi i këtij ligji

1. Mbikëqyrjen për zbatimin e këtij Ligji e bën Ministria e Punëve të Brendshme.
2. Mbikëqyrjen dhe inspektimin për zbatimin e këtij Ligji për pjesën që ka të bëjë me punën e të huajve në Kosovë e bën organi kompetent i ministrisë përkatëse.

KREU XIII

EVIDENCAT

Neni 88

Ruajtja e të Dhënave Personale

1. Të gjitha të dhënat personale të mbledhura dhe dokumentet e lëshuara gjatë zbatimit të këtij ligji mbahen, ruhen dhe evidentohen në evidencën e organeve përgjegjëse.
2. Të dhënat personale të regjistruara në evidencat nga paragrafi 1 i këtij neni mbahen, përdoren dhe procesohen sipas dispozitave të Ligjit në fuqi për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU XIV

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 89

Rrethanat për Hyrje dhe Qëndrim

1. Me rastin e vendosjes për hyrje dhe/ose qëndrim të të huajit, organet vendim marrëse duhet ti kenë parasysh rrethanat si në vijim :
 - 1.1. ashpërsinë apo llojin e veprës së kryer kundër sigurisë dhe politikës publike nga i huaji apo nga anëtarët e familjes së tij/saj ose nga rreziku që vjen nga personi (at) në fjalë;

1.2. marrëdhënien dhe natyrën e afërsisë së familjes së personit (ave) dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të tij/saj në Republikën e Kosovës dhe lidhjen sociale, kulturore dhe praninë e familjes së tij/saj në shtetin e origjinës.

2. Vendimi për ta anuluar qëndrimin e përhershëm nuk duhet të merret bazuar vetëm në rrethanat ekonomike. Me rastin e marrjes së vendimit për anulimin e qëndrimit të përhershëm, organet duhet ti kenë parasysh këto gjëra:

2.1. kohëzgjatja e deri atëherëshme e qëndrimit të tij/saj në Republikën e Kosovës;

2.2. mosha e personit(ve) në fjale;

2.3. pasojat e mundshme për personin(at) apo anëtarët e familjes së tij/saj.

2.4. lidhjet me Republikën e Kosovës ose mungesën e lidhjes së tij/saj me shtetin e origjinës.

Neni 90

Lajmërimi Zyrtar

Nëse i huaji nuk e informon organin kompetent për ndërrimin e adresës apo në adresën në të cilën është i lajmëruar nuk mund të gjendet, flet dërgesa e vendimit realizohet nëpërmjet shpalljes zyrtare dhe do të konsiderohet si e pranuar që nga data e publikimit të tij.

Neni 91

Të Drejtat e Azil Kërkuesve

1. Të drejtat e të huajve që kërkojnë, ose është e arsyeshme të besohet se mund të kërkojnë, çfarëdo formë të mbrojtjes të cekur në nenet 4 ose 55 të Ligjit për Azil në Kosovë, gjithmonë duhet të përcaktohen në përputhje me dispozitat e atij ligji.

2. Asnjë nga dispozitat e këtij ligji nuk duhet të interpretohet si anash kaluese e obligimeve të shtetit në kuadër të Konventës Lidhur me Statusin e Refugjateve të viti 1951, të amenduar me Protokollin e vitit 1967 lidhur Statusin e Refugjatëve.

Neni 92

Aktet Nënligjore të Ministrisë së Punëve të Brendshme

1. Ministria e Punëve të Brendshme do të nxjerre akte nënligjore për:

1.1. formën dhe procedurat e aplikimit për dokumentet e udhëtimit, vizave, lejimin e qëndrimit të përkohshëm dhe të përhershëm, lajmërimin dhe ç’lajmërimin e vendbanimit apo të vendqëndrimit si dhe mënyrën e udhëheqjes së evidencës për të huajt.

1.2. formularët e dokumenteve të udhëtimit, të vizave, lejeve kufitare, letërnjoftimeve për të huaj, lejet për qëndrim të përkohshëm dhe të përhershëm, formularët për deportim, për ndërprerjen e qëndrimit, dokumentet për ndalim të përkohshëm të të huajve, vërtetimet për konfiskimin e mjeteve financiare, vërtetimet për inkasimin e shpenzimeve të largimit të dhunshëm, vërtetimet për marrjen e përkohshme të dokumenteve.

1.3. përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së evidencës në bazë të këtij ligji.

1.4. deportimin, mbajtjen në Qendër dhe qëndrimin e përkohshëm të të huajve.

Neni 93

Aktet Nënligjore të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme

1. Ministria e Punëve të Jashtme, në pajtueshmëri me Ministrinë e Punëve të Brendshme, do të nxjerrë akte nënligjore për:

1.1 mënyrën e lëshimit të dokumenteve të udhëtimit dhe vizave të huajve në misionet diplomatike respektivisht në zyrat e konsullare të Republikës së Kosovës jashtë vendit,

1.2 mënyrën e udhëheqjes së evidencës mbi lëshimin e dokumenteve të udhëtimit si dhe vizave të të huajve në misionet diplomatike gjegjësisht në zyrat e konsullare të Republikës së Kosovës jashtë vendit,

1.3. formën e dhënies dhe formularin e vizave, formularin e letërnjoftimeve të posaçme si dhe formularin e kërkesave për lëshimin e saj dhe mënyrën e udhëheqjes së evidencës për vizat e lëshuara dhe letërnjoftimet si dhe çmimin e tyre.

Neni 94

Vlefshmëria e Dokumenteve të UNMIK-ut

Dokumentet e lëshuara në bazë të dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/16 mbi Lëvizjen e Personave Brenda dhe Jashtë Kosovës dhe Urdhërësës Administrative 2005/08 do të vlejnjë për afatin që janë lëshuar mirëpo jo më gjatë se një vit nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 95

Gjobat

1. Organet përgjegjëse do t'u shqiptojnë dënime individëve dhe personave juridik që shkelin

dispozitat e këtij ligji.

2. Lloji i shkeljes dhe lartësia e gjobës përcaktohet me akt nënligjor nga organi kompetent menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji

Neni 96
Aktet Nënligjore

Ministria e Punëve të Brendshme do të nxjerr aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 97
Shfuqizimi i Akteve

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizon të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë.

Neni 98
Hyrja ne fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-126
16 dhjetor 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI